



**KRYETARI I KOMUNËS**

14-422/01-257667/22 më 25. 11. 2022

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

**V E N D I M**  
**P Ë R**  
**SHFRYTËZIMIN E SHËRBIMEVE NGA BUFEJA**

- I. LEJOHET shfrytëzimi i shërbimeve nga bufeja në objektin e vjetër të Komunës dhe në objektin e ri, në Arbëri, nga pozicioni "para e gatshme".
- II. Shfrytëzues të shërbimeve të bufesë janë:
  1. Kryetari i Komunës;
  2. Nënkryetarët e Komunës;
  3. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës;
  4. Drejtorët e drejtorive;
  5. Udhëheqësit e sektorëve të kabinetit të Kryetarit dhe të drejtorive.
- III. Shuma e mjeteve që do të ndahet sipas pikës II të këtij Vendimi është:
  1. Kryetari i Komunës, shumë të pacaktuar;
  2. Nënkryetarët e Komunës, shumë të pacaktuar;
  3. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, shumë të pacaktuar;
  4. Drejtorët e drejtorive, 100 €;
  5. Udhëheqësit e sektorëve të kabinetit të Kryetarit dhe të drejtorive, 30 €.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave.
- V. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi me nr. 14-030/01-0280949/19 e dt. 14.11.2019.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**U DORËZOHET:**

- Drejtorisë së Financave;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.



**KRYETARI I KOMUNËS**  
Përparim Rama